



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0489

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Alhena Law Office " L.L.C., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KOMUNA DRENAS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Shërbime të përfaqësimit në procedura gjyqësore për nevoja të Komunës së Drenasit me numër të prokurimit 611-23-1507-2-1-1, me 07/09/2023, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Alhena Law Office” L.L.C., e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 12.07.2023 me numër protokolli 489/2023 për aktivitetin e prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Shërbime të përfaqësimit në procedura gjyqësore për nevoja të Komunes së Drenasit me nr. të prokurimit: 611-23-1507-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- Komuna Gllogoc, duke u konsideruar si çështje e gjykuar (res judicata) pasi që pretendimet ankimore në këtë ankesë janë të njëjta si në Vendimin PSh. nr.2023/0222 i datës 13.06.2023, ku objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta.

2. OBLIGOHET Autoriteti Kontraktues- Komuna e Drenasit të zbatojë vendimin e OSHP-së me numër: PSh. nr.2023/0222 i datës 13.06.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbime të përfaqësimit në procedura gjyqësore për nevoja të Komunes së Drenasit me nr. të prokurimit: 611-23-1507-2-1-1.

3. URDHËROHET Autoriteti Kontraktues- Komuna e Drenasit, që në afat prej 5 (pesë) ditësh kalendarike të njoftoj OSHP-në lidhur me zbatimin e vendimit të OSHP-së: PSh.nr.2023/0222 i datës 13.06.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbime të përfaqësimit në procedura gjyqësore për nevoja të Komunes së Drenasit me nr. të prokurimit: 611-23-1507-2-1-1.

4. Mos respektimi i kësaj urdhërese në afat prej pesë ditësh kalendarike do ta detyrojë Panelin Shqyrtues që të veproj konform nenit 131 të LPP-së dhe në të njëjtën kohë të kërkojë nga KRPP-ja, anulimin e licencës për menaxherin e prokurimit të AK-së /Komuna e Drenasit, konform nenit 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

5. Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së paguar me parashtrimin e ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 01.03.2023, Komuna Drenas, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Sherbime të përfaqësimit në procedura gjyqësore për nevoja të Komunes së Drenasit” me nr. të prokurimit: 611-23-1507-2-1-1. Nderkaq me datën 05.07.2023 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK.

(OE) “Alhena Law Office” L.L.C. me datën 03.07.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK.

Me datën 05.07.2023, AK- Komuna e Drenas me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE “Alhena Law Office” L.L.C. lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sherbime të përfaqësimit në procedura gjyqësore për nevoja të Komunes së Drenasit” me numër të prokurimit “611-23-1507-2-1-1” të inicuar nga AK- Komuna Drenas.

AK në vendim ka kërkuar të Refuzohet si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues “Alhena Law Office” L.L.C me datën 12.07.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 489/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: **150,000.00 €**.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 24.07.2023 eksperti shqyrtues ka

dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Eksperti Shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që lënda të trajtohet si çështje e gjykuar "**Res Juridikat**" sipas legjislacionit në fuqi dhe sipas vendimit paraprake të **PSH.OSHP Nr. 2023/0222 i dt:13.06.2023** dhe procedura të kthehet në Rivleresim.ankesa e OE "Alhena Law Office "L.L.C.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Eksperti shqyrtues pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit si dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore të palës në ankesë sqaron si vijon:

Lidhur me pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues së autoriteti kontraktues Komuna e Glllogovc, ka shëllur Nenin,1, Qëllimi, par 1; 2 dhe 3,Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, par 1, Neni 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi, par 1,2 dhe 6,Neni 51, Njoftimi i Kriterëve të Përzgjedhjes, par 1, Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave, par 1, nen par 1.1 dhe 1.2 dhe par 56.3, Neni 60, Kriteret për Dhënien e Kontratës, par 1, nen par 1.1, Neni 108/A, Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, par 8, nen par 8.4, Neni 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, Neni 97, Shkeljet e rënda, par 97.1 nen par (d), (h) dhe (o), të LPP-së si dhe III. Mos respektim të vendimit të OSHP-se, PSH (Nr. 2023/0222 i dt:13.06.2023).

Duke pasur parasysh pretendimet ankimore si dhe bazuar në për qështjen dhe palet e njeta është nxerrur një vendim nga PSH.OSHP me datën 13.06.2023 me nr.2023/0222, Eksperti shqyrtues në bazë të Rregullores Nr.01/2020 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, Nenin 16 (Rastet e unifikuar) paragrafi 2 dhe 3 që citohet: Në rastet e përsëritur me pretendimet të njeta ku objekti i kontestit dhe palët janë të njëjtat për rastet të cilat janë shqyrtuar edhe më parë duhet që të trajtohen si çështje të gjykuara „res juridikat” në kuptim të Nenit 105 paragrafit 2.16 të LPP-së.

Andaj bazuar në këtë pretendimet e njeta ankimore nuk janë trajtuar nga eksperti shqyrtues, pasi që Vendimet e PSH.OSHP nuk mundën të komentohen as interpretohen nga ana e ekspertit, për këtë rast është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më **Nr. 2023/0222 i dt:13.06.2023** dhe nga pikpamja ligjore është rast i gjykuar.

Eksperti shqyrtues sqaron, se AK (Komuna e Glllogovcit), komisioni i vlerësimit nuk ka vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar drejt ofertat e operatoreve ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit dhe nuk ka respektuar Vendimin e PSH.OSHP Nr. 2023/0222 i dt:13.06.2023, duke mos vepruar në tërësi në pajtim me dispozitat ligjore të LPP-së, Nenin 59 dhe 62.

Eksperti shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë më ekonomike njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në Nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe Nenin 1 të LPP-së pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, me transparente, jo diskriminuese dhe me të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve në mënyrë të duhur dhe ligjore.

- Konstatimi i Panelit Shqyrtues -

Paneli Shqyrtues konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij si dhe mbështet rekomandimin e ekspertit që lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Paneli vlerëson se Autoriteti Kontraktues - Komuna e Drenasit, zyrtari përgjegjës i prokurimit dhe komisioni i ri-vlerësimit gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, nuk e ka marrë për bazë fare Vendimin e OSHP- së nr. 2023/0222 të datës 13.06.2023, andaj, ankesa e OE ankues përsëritet për herë të dytë dhe se ankesa konform Rregullores së Punës së OSHP-së konkretisht neni 16.2 të trajtohet si “Res Judicata”.

Po ashtu neni 105 paragrafi 2.16 i LPP-së sqaron: “Në rastet e përsëritura me të njëjtat pretendime ankimore, ku objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, në rastet të cilat janë shqyrtuar më parë, Kryetari i Panelit Shqyrtues i trajton si çështje të gjykuara “res judicata”.

Në bazë të sqarimeve të lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozojnë panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në Rivlerësim.

Pas analizimit të shkresave të lartpërmendura të cilat i kishte në dispozicion Paneli Shqyrtues, si: Ankesat e OE ankues, raportet e ekspertit shqyrtues, vendimin nr.2023/0222, dihet mirë se vendimet e OSHP-së janë të detyrueshme për autoritetet kontraktuese dhe të gjitha palët në procedurë, dhe se kundër vendimeve të OSHP-së, palët mund të ankohen në gjykatën kompetente brenda afatit ligjor me mjete të rregullta juridike, në përputhje me këshillën juridike të dhënë në vendim.

Andaj, Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna e Drenasit që në tërësi të zbatohet vendimi i PSH nr.285/22. OSHP-ja urdhëron Autoritetin Kontraktues (AK) - Ministria e Punëve të Brendshme që të ndërmarr masa për zbatimin e vendimit të lartpërmendur në afat prej pesë (5) ditësh, mos respektimi i këtij urdhri, në afat prej pesë ditësh kalendarike, do ta detyrojë panelin shqyrtues që të respektoj nenin 131 të LPP-së dhe njëkohësisht do të kërkojë nga KRPP-ja që ti anulojë licencën menaxherit të prokurimit të Autoritetit Kontraktues (AK) - Komuna e Drenasit në pajtim me nenin 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 56.3, 59 dhe 60 të LPP, të cituara në Ankesë. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA GLLOGOC**
- **OE - Alhena Law Office " L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: